

KËSHILLË E PËRGJITHSHME
RRETH DISA PREJ
**GJYNAHEVE
TË MËDHA**

SHËJKN 'ABDUL'AZIZ IBËN BAZ





Këshillë e përgjithshme rreth disa prej gjynaheve të mëdha.

Nga Abdul-‘Aziz bin Abdilah bin Baz për tek ai që e sheh apo e lexon këtë prej vëllezërve të mi muslimanë. Allahu më dhëntë sukses mua dhe atyre në atë që Ai është i kënaqur, dhe më largoftë mua dhe ata nga ato gjëra që e hidhërojnë dhe janë mosbindje ndaj Tij, amin.

Es selamu alejkum ue rahmetullahi ue berekatuhu.

E më pas:

Këshilla ime për çdo musliman është që të ketë frikë (tekua) Allahun - *Subhanehu ue Te'ala* - në të gjitha gjendjet dhe ta ruajë gjuhën e tij nga të gjitha fjalët, përveç fjalëve që mendon se kanë ndonjë dobi, sepse ndodh që fjalët e lejuara të tërheqin te fjalët e ndaluara apo të urryera, dhe kjo ndodh shumë midis njerëzve. Allahu - *Subhanehu ue Te'ala* - thotë:

مَا يَلْفِظُ مِنْ قَوْلٍ إِلَّا لَدَيْهِ رَقِيبٌ عَتِيدٌ ﴿١٨﴾

“Ai nuk flet ndonjë fjalë e të mos jetë pranë tij përcjellësi (engjëlli) i gatshëm (që nuk lë asgjë pa shkruar).”¹

¹ Kaf, 18.

Dhe thotë i Lartësuari:

وَلَا تَقْفُ مَا لَيْسَ لَكَ بِهِ عِلْمٌ إِنَّ السَّمْعَ وَالْبَصَرَ وَالْفُؤَادَ كُلُّ أُولَئِكَ كَانَ عَنْهُ
مَسْئُولًا ﴿٣٦﴾

“Mos iu qas asaj për të cilën nuk ke njohuri, sepse të dëgjuarit, të pamurit dhe zemra, për të gjitha këto ka përgjegjësi.”²

Dhe thotë i dërguari - *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem* - në hadith të saktë (mutefekun alejhi) të cilin e transmeton Ebu Hurejra - *radi Allahu anhu* - :

مَنْ كَانَ يُؤْمِنُ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ ، فَلْيُكُنْ خَيْرًا أَوْ لِيَصْمُتْ

“Kush beson në Allahun dhe në Ditën e Fundit ose të flasë fjalë të mirë ose të heshtë.”

Ka disa gjëra që vijnë si rezultat i llafeve dhe duhet tërhequr vërejtja dhe duhet paralajmëruar kundër tyre për shkak se ato janë prej gjynaheve të mëdha të cilat obligojnë Hidhërimin e Allahut dhe dënimin e Tij të dhimbshëm. Tashmë këto janë përhapur në disa shoqëri, prej tyre është:

² Isra, 36.

1. Gibeti: që është përmendja e vëllait tënd me diçka të cilën ai do e urrente nëse do ta merrte vesh. Nuk ka ndryshim a e përmende atë me një të metë në fenë e tij apo në prejardhjen e tij apo në moralin e tij apo në fjalën e tij apo në fenë e tij apo për dynjanë, madje edhe nëse e përmend për rrobat ose për kafshën e tij.

Transmetohet nga Ebu Hurejra - *radi Allahu anhu* - që i dërguari i Allahut - *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem* - ka thënë:

" أَتَدْرُونَ مَا الْغَيْبَةُ . قَالُوا اللَّهُ وَرَسُولُهُ أَعْلَمُ . قَالَ "ذِكْرُكَ أَخَاكَ بِمَا يَكْرَهُ" . قِيلَ أَفَرَأَيْتَ إِنْ كَانَ فِي أَخِي مَا أَقُولُ قَالَ "إِنْ كَانَ فِيهِ مَا تَقُولُ فَقَدْ اغْتَبْتَهُ وَإِنْ لَمْ يَكُنْ فِيهِ فَقَدْ بَهْتَهُ"

“A e dini se ç’është gibeti? Thanë: Allahu dhe i dërguari i Tij e dinë më së miri. Tha: “Përmendja e vëllait tënd me diçka të cilën ai e urren”. Dikush tha: Si mendon nëse ajo që unë them për vëllain tim është e vërtetë? Tha: “Nëse është e vërtetë ajo që ti thua për të, atëherë ti e ke përgojuar atë, e nëse nuk është e vërtetë ajo që thua për të, atëherë ti ke shpifur për të.”³

Gibeti (përgojimi) është haram për çfarëdolloj sebepi qoftë. Njësoj është si për shuarjen e zemërimit apo për t’ju bërë qejfin (lajka) dhe për të mbajtur me muhabet bashkëbiseduesit apo për t’u hequr (sikur je dikushi) apo për hased apo për t’u dëfryer apo për shaka që të kalojë koha. Kështu ai përmend të metat e të tjerëve (vëllezërve të tij) për të qeshur (me bashkëbiseduesit), kur Allahu - *Subhanehu ue*

³ Transmeton Muslimi.

Te'ala - ka ndaluar nga kjo dhe i ka paralajmëruar robërit e Tij prej saj në Fjalën e Tij - 'Azze ue Xhel-le - :

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا اجْتَنِبُوا كَثِيرًا مِّنَ الظَّنِّ إِنَّ بَعْضَ الظَّنِّ إِثْمٌ وَلَا تَجَسَّسُوا وَلَا يَغْتَب بَّعْضُكُم بَعْضًا أَتُحِبُّ أَحَدُكُمْ أَن يَأْكُلَ لَحْمَ أَخِيهِ مَيْتًا فَكَرِهْتُمُوهُ
وَاتَّقُوا اللَّهَ إِنَّ اللَّهَ تَوَّابٌ رَّحِيمٌ ﴿١٢﴾

“O ju që keni besuar, largohuni prej dyshimeve (akuzave të pavend) të shumta, meqë disa dyshime janë mëkat dhe mos hulumtoni për zbulimin e të metave të njëri-tjetrit dhe mos përgojoni njëri-tjetrin; a mos ndonjëri prej jush dëshiron të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur? Atë pra e urreni! Kini frikë nga ndëshkimi i Allahut, e Allahu është Mëshirues, Ai pranon shumë pendimin.”⁴

Dhe në hadith nga Ebu Hurejra - radi Allahu anhu - që i dërguari i Allahut - sal-lAllahu alejhi ue sel-lem - ka thënë:

كُلُّ الْمُسْلِمِ عَلَى الْمُسْلِمِ حَرَامٌ، دَمُهُ، وَمَالُهُ، وَعَرَضُهُ

“Çdo musliman e ka haram gjakun, pasurinë dhe nderin e vëllait të tij musliman.”⁵

⁴ Huxhurat, 12.

⁵ Transmeton Muslimi.

Dhe ka thënë i dërguari i Allahut - *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem* - në fjalimin e tij në haxhin e lamtumurës:

إِنَّ دِمَاءَكُمْ وَأَمْوَالَكُمْ عَلَيْكُمْ حَرَامٌ كَحُرْمَةِ يَوْمِكُمْ هَذَا فِي شَهْرِكُمْ هَذَا فِي بَلَدِكُمْ هَذَا أَلَا هَلْ بَلَغْتُ

“Padyshim se gjaku juaj, pasuria juaj, nderi juaj, janë të shenjta për ju (që mos t’i cenoni ato padrejtësisht) ashtu sikurse është e shenjtë kjo ditë (dita e Kurban Bajramit), në këtë muaj (Dhul-Hixheh), në këtë vend (Mina), a jua kumtova?”⁶

Dhe nga Ebu Hurejra - *radi Allahu anhu* - të thotë: Ka thënë i dërguari i Allahut - *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem* - :

إِنَّ مِنْ أَرْبَى الرَّبَا الْإِسْطَاطَالَةَ فِي عَرْضِ الْمُسْلِمِ بِغَيْرِ حَقٍّ

“Prej gjynaheve më të mëdha është që njeriu të flasë padrejtësisht për nderin e vëllait të tij.”⁷

Dhe hadithet e sakta nga i dërguari Allahut - *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem* - për ndalimin, qortimin, dhe paralajmërimin kundër gibeitit (përgojimit) janë të shumta.

⁶ Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

⁷ Transmeton Bezari dhe Ebu Daudi.

2. Prej gjërave që duhet shmangur, duhet larguar dhe duhet paralajmëruar prej tyre janë **thashethemet** (en-nemijmetu), e cila është mbartja e fjalëve nga një person tek një person tjetër, ose prej një grupi tek një grup tjetër, ose nga një fis tek një fis tjetër, duke pasur për qëllim prishjen dhe futjen e tyre në sherr me njeri tjetrin. Dhe kjo është që të zbulohet (të tregohet) diçka që urrehet të zbulohet, qoftë nga ana e atij që e përcjell ose nga ana e atij që i përcillet ose një person i tretë e urren atë (fjalë që ka dalë). Dhe nuk ka dallim a është ky zbulim (thashetheme) me fjalë apo me shkrim apo duke bërë me shenjë apo me gjepte. Nuk ka dallim a u zbulua diçka prej fjalëve apo prej veprave dhe sidoqoftë qëndron apo nuk qëndron kjo (thashetheme) si e metë apo mangësi e atij për të cilin (thashethemexhiu) ka transmetuar. Pra, është detyrë që njeriu të heshtë për çdo gjë që shikon prej gjendjes së njerëzve, përveç atyre gjërave që nëse i tregon ka dobi për ndonjë musliman ose shmanget ndonjë sherr.

Dhe motivi që e shtyn robin për thashetheme është ose keqdashja ndaj atij që po përcjell, ose shfaqja e dashurisë ndaj atij të cilit po i tregon, ose argëtimi duke u marrë me llafe, ose zhytja në kureshtje dhe të kota. Dhe të gjitha këto janë haram. Dhe çdo njeriu që i tregohet kjo thashetheme në çdo formë prej formave të thashethemeve, ai e ka detyrë që mos ta besojë atë, sepse thashethemexhiu konsiderohet gjynahqar i madh (fasik) dhe i refuzohet dëshmia. Allahu i Lartësuar thotë:

يَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا إِن جَاءَكُمْ فَاسِقٌ بِنَبَأٍ فَتَبَيَّنُوا أَن تُصِيبُوا قَوْمًا بِجَهْلَةٍ فَتُصْبِحُوا

عَلَىٰ مَا فَعَلْتُمْ نَادِمِينَ ﴿٦﴾

“O ju që keni besuar, nëse ndonjë gjynahqarë u sjell ndonjë lajm, ju shqyrtojeni mirë atë (lajmin), ashtu që të mos e dëmtoni ndonjë popull pa e ditur realitetin, e pastaj të pendoheni për atë që keni bërë.”⁸

Dhe ai duhet ta ndalojë thashethemexhiun nga thashethemet, ta këshillojë atë dhe t’ia neverisë veprën e tij (thashethemexhiut) për shkak të Fjalës së Allahut të Lartësuar:

وَأْمُرْ بِالْمَعْرُوفِ وَانْهَ عَنِ الْمُنْكَرِ

“...urdhëro për punë të mira, e ndalo nga të këqijat...”⁹

Dhe ta urrejë thashethemexhiun për hir të Allahut dhe mos të mendojë keq për vëllanë, për të cilin i foli thashethemexhiu, porse duhet të mendojë mirë për vëllanë e tij, për shkak të Fjalës së Allahut të Madhëruar:

يَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا اجْتَنِبُوا كَثِيرًا مِّنَ الظَّنِّ إِنَّ بَعْضَ الظَّنِّ إِثْمٌ

⁸ Huxhurat, 6.

⁹ Lukman, 17.

“O ju që keni besuar, largohuni prej dyshimeve (akuzave të pavend) të shumta, meqë disa dyshime janë mëkat.”¹⁰

Dhe për shkak të fjalës së të Dërguarit të Allahut - *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem* - :

إِيَّاكُمْ وَالظَّنَّ، فَإِنَّ الظَّنَّ أَكْذَبُ الْحَدِيثِ

“Largohuni nga paragjykimi sepse paragjykimi është gënjeshtër më e madhe.”¹¹

Dhe ai nuk duhet ta hulumtojë vëllanë, për të cilin i foli thashethemexhiu, gjithashtu nuk duhet të kënaqet me atë gjë prej së cilës e ndaloi thashethemexhiun, duke e përhapur vetë atë thashetheme.

Dhe argumentet nga Kurani dhe Suneti që i ndalojnë thashethemet janë të shumta. Prej tyre është Fjala e të Lartësuarit:

وَلَا تُطْعَ كُلَّ حَلَّافٍ مَّهِينٍ ﴿١٠٠﴾ هَمَّازٍ مَّشَاءٍ بِنَمِيمٍ ﴿١٠١﴾

“Mos iu bind askujt që betohet shumë dhe është gënjeshtar. Që është përgojues e bart fjalën ndër njerëz.”¹²

¹⁰ Huxhurat, 12.

¹¹ Mutefekun alejhi.

Dhe Fjala e të Lartësuarit:

وَيْلٌ لِّكُلِّ هُمَزَةٍ لُّمَزَةٍ ﴿١﴾

“Mjerë për secilin që ofendon e përqesh (njerëzit).”¹³

Transmetohet nga Hudhejfja - *radi Allahu anhu* - se i dërguari i Allahut - *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem* - ka thënë:

لَا يَدْخُلُ الْجَنَّةَ نَمَامٌ

“Nuk hyn në xhenet thashethemexhiu.”¹⁴

Transmetohet nga ibn Mes'udi - *radi Allahu anhu* - që peygamberi - *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem* - ka thënë:

أَلَا أُنبِّئُكُمْ مَا الْعَصَةُ هِيَ النَّمِيمَةُ الْقَالَةُ بَيْنَ النَّاسِ

“A t'ju tregoj se ç'është magjia (sihri)? Ajo është mbartja e thashethemeve ndërmjet njerëzve.”¹⁵

¹² Kalem, 10-11.

¹³ Humeze, 1.

¹⁴ Mutefekun alejhi.

¹⁵ Transmeton Muslimi.

Gjithashtu thashethemet janë sebeb që e obligojnë dënimin e varrit, sipas asaj që transmeton ibn Abasi - *radi Allahu anhumā* - që i dërguari Allahut - *sal-lAllahu alejhi ue sellem* - kaloi pranë dy varreve dhe tha:

إِنَّهُمَا لِيُعَذَّبَانِ وَمَا يُعَذَّبَانِ فِي كَبِيرٍ أَمَّا أَحَدُهُمَا فَكَانَ لَا يَسْتَتِرُ مِنَ الْبَوْلِ، وَأَمَّا الْآخَرُ فَكَانَ يَمْشِي بِالنَّمِيمَةِ

“Të dy po dënohen dhe nuk po dënohen për diçka të madhe, (sepse ata nuk e shikonin si gjë të madhe atë që bënin), përkundrazi (ajo është e madhe tek Allahu), njëri prej tyre nuk pastrohej prej urinës ndërsa tjetri merrej me thashetheme.”¹⁶

Vërtet që gibeti dhe thashethemet u ndaluan (haram) për arsyen, sepse nëpërmjet tyre nxitet për të prishur midis njerëzve. Për të krijuar përçarje, rrëmuje, si dhe për ndezjen e zjarrit të armiqësisë, urrejtjes, të hasedit dhe të hipokrizisë (nifakut). Ato zhdukin çdo miqësi dhe vrasin çdo dashuri, duke futur përçarjen, hasmërinë dhe ushqejnë urrejtje ndërmjet vëllezërve besnikë e të sinqertë.

Gjithashtu ato janë ndaluar (haram) për shkak se përmbajnë gënjeshtër, pabesi (dhelpëri), tradhti, mashtrim, dhe pafundësi akuzash të kota kundrejt njerëzve të pafajshëm, duke mos i bërë përshtypje (thashethemexhiut) sharjet, ofendimet dhe përmendja e gjërave të neveritshme dhe sepse ato, (gibeti dhe thashethemet),

¹⁶ Mutefekun alejhi.

janë shenja që tregojnë frikën, poshtërsinë dhe dobësinë e tij (gibetçiut dhe thashethemexhiut).

Duke shtuar këtu, se përgojuesit dhe thashethemexhinjtë do mbajnë mbi supe gjynahe të shumta të cilat do i shtyjnë ata për në Hidhërimin dhe Zemërimin e Allahut dhe për në dënimin e Tij të dhimbshëm.

3. Dhe prej gjërave që është detyrë shmangia dhe largimi prej saj, është cilësia e urryer e cila është **smira (hasedi)** dhe hasedi është që njeriu të dëshirojë largimin e begatisë nga vëllai i tij (musliman), pa dallim a është begati në fe apo në dunja dhe kjo është në kundërshtim me atë që ka caktuar Allahu dhe e ka ndarë midis robërve të Tij, duke u dhuruar atyre me dhuntinë e Tij. Ndërsa, zullumi i hasedxhiut është kundër vetes së tij. Pra, atij do i pakësohet imani prej hasedit dhe kjo do ti sjellë atij fatkeqësi dhe telashe kundër vetes së tij, duke e shkatërruar atë me një shkatërrim të pashmangshëm. Thotë Allahu i Lartësuar:

أَمْ تَحْسُدُونَ النَّاسَ عَلَىٰ مَا آتَاهُمُ اللَّهُ مِنْ فَضْلِهِ ۖ

“A u kanë zili atyre njerëzve për atë që Allahu u dha nga mirësitë e Tij?”¹⁷

Transmetohet prej Ebu Hurejres - *radi Allahu anhu* - që i Dërguari i Allahut - *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem* - ka thënë:

¹⁷ Nisa, 54.

لَا تَحَاسَدُوا وَلَا تَنَاجَشُوا, وَلَا تَبَاغَضُوا, وَلَا تَدَابَرُوا, وَلَا يَبِعْ بَعْضُكُمْ عَلَى بَيْعِ بَعْضٍ,
وَكُونُوا عِبَادَ اللَّهِ إِخْوَانًا

“Mos e kini zili njëri-tjetrit, mos e urreni njeri-tjetrit, mos ia ktheni shpinën njëri-tjetrit dhe mos ndërhyri në shitblerjet e njëri-tjetrit, por jini robër të Allahut – vëllezër.”¹⁸

Gjithashtu transmetohet nga Ebu Hurejra - *radi Allahu anhu* - që i Dërguari i Allahut - *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem* - ka thënë:

إِيَّاكُمْ وَالْحَسَدَ, فَإِنَّ الْحَسَدَ يَأْكُلُ الْحَسَنَاتِ, كَمَا تَأْكُلُ النَّارُ الْحَطَبَ

“Ruhuni nga hasedi, sepse hasedi i ha veprat e mira sikurse zjarri që i djeg drutë.”¹⁹

4. Sikurse duhet larguar prej **zullumit** dhe zullum d.m.th: vendosja e diçkaje jo në vendin e saj sheriatik, dhe zullumi më i madh është ti bësh shok Allahut - *Subhanehu ue Te'ala* - dhe shfaqja e kundërshtimit dhe mos bindjes ndaj Tij. Thotë Allahu - *Subhanehu ue Te'ala* - :

إِنَّ الشِّرْكَ لَظُلْمٌ عَظِيمٌ ﴿١٣﴾

¹⁸ Transmeton Muslimi.

¹⁹ Transmeton Ebu Daudi.

“Padyshim që idhujtaria është padrejtësia më e madhe.”²⁰

Dhe thotë Allahu - ‘Azze ue Xhel-le - :

وَالْكَافِرُونَ هُمُ الظَّالِمُونَ

“Pabesimtarët janë zullumqarë.”²¹

Dhe prej zullumit është marrja e pasurisë së tjetrit padrejtësisht ose uzurpimi i një pjese prej tokës së tij ose sulmimi i tij edhe kjo gjithashtu është nga gjynahet e mëdha dhe mosbindje ndaj Allahut dhe kjo - Allahu na ruajtë - rrjedh nga errësira që është në zemër, sepse nëse do të ishte ndriçuar zemra e tij me dritën e udhëzimit, atëherë ai do të kishte marrë mësim.

Thotë Allahu - Subhanehu ue Te'ala - :

مَا لِلظَّالِمِينَ مِنْ حَمِيمٍ وَلَا شَفِيعٍ يُطَاعُ

“Për zullumqarët nuk ka as mik e as ndërmjetësues që i pranohet fjala.”²²

Dhe thotë i Lartësuari:

وَمَا لِلظَّالِمِينَ مِنْ نَصِيرٍ

²⁰ Llukman, 13.

²¹ Bekare, 254.

²² Gafir, 18.

“Për idhujtarët nuk ka ndonjë ndihmëtar.”²³

Dhe thotë i Lartësuari:

وَلَا تَحْسَبَنَّ اللَّهَ غَفْلًا عَمَّا يَعْمَلُ الظَّالِمُونَ إِنَّمَا يُؤَخِّرُهُمْ لِيَوْمٍ تَشْخَصُ فِيهِ
الْأَبْصَارُ

“E ti kurrësi mos e mendo Allahun si të pakujdesshëm ndaj asaj që veprojnë zullumqarët; Ai vetëm është duke i lënë ata për në Ditën kur do të shtangen sytë.”²⁴

Dhe thotë i Lartësuari:

وَمَنْ يَظْلِمِ مِّنْكُمْ نَذِقْهُ عَذَابًا كَبِيرًا ﴿٦٨﴾

“E cilido që bën padrejtësi prej jush, Ne i japim atij të përjetojë një dënim të madh.”²⁵

Dhe në Sahihun e Muslimit nga Ebu Dherri - *radi Allahu anhu* - që i Dërguari i Allahut - *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem* - ka thënë:

يَا عِبَادِي إِنِّي حَرَّمْتُ الظُّلْمَ عَلَى نَفْسِي وَجَعَلْتُهُ بَيْنَكُمْ مُحَرَّمًا فَلَا تَظَالَمُوا

²³ Haxhxxh, 71.

²⁴ Ibrahim, 42.

²⁵ Furkan, 19.

“Thotë Allahu i Lartësuar: “O robërit e Mi! Unë ja ndalova padrejtësinë Vetes Time e edhe midis jush e bëra të ndaluar, prandaj mos i bëni padrejtësi njëri-tjetrit.”

Dhe transmetohet nga Xhabiri - *radi Allahu anhu* - që i Dërguari i Allahut - *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem* - ka thënë:

اتَّقُوا الظُّلْمَ، فَإِنَّ الظُّلْمَ ظُلُمَاتٌ يَوْمَ الْقِيَامَةِ

“Ruhuni nga padrejtësia, sepse padrejtësia është errësirë në Ditën e Kijametit.”

Dhe transmetohet nga Abdilah bin Amr bin 'As - *radi Allahu anhuma* - që i Dërguari i Allahut - *sal-lAllahu alejhi ue selem* - ka thënë:

الْمُسْلِمُ مَنْ سَلِمَ الْمُسْلِمُونَ مِنْ لِسَانِهِ وَيَدِهِ وَالْمُهَاجِرُ مَنْ هَجَرَ مَا نَهَى اللَّهُ عَنْهُ

“Musliman është ai, që prej gjuhës dhe dorës së tij janë të sigurt muslimanët dhe muhaxhir është ai, që u largohet ndalesave të Allahut.”²⁶

Këto hadithe dhe hadithet e tjera që kanë ardhur me këtë kuptim, argumentojnë se obligohemi që të kemi kujdes nga padrejtësia ndaj njerëzve, në ndere dhe në pasuri, për shkak se në këtë gjë, ka sherr dhe fesad të madh dhe ka pasoja të rënda. Gjithashtu, ato argumentojnë për obligimin e pendimit (teubes) tek Allahu -

²⁶ Mutefekun alejhi.

Subhanehu ue Te'ala - për çfarë ka kaluar prej këtyre gjërave dhe të ketë këshilla të ndërsjella për largimin nga ajo që ka ndaluar Allahu prej padrejtësisë dhe gjynaheve të tjera.

Allahu më dhëntë sukses mua dhe juve për morale dhe punë të mira, dhe na largoftë prej moraleve të prishura dhe punëve të këqija, dhe na udhëzoftë në rrugën e Tij të drejtë. Vërtet që, Ai është Fisnik dhe Bujar.

Lavdërimet, shpëtimi dhe begatitë e Allahut qofshin për Pejgamberin tonë, Muhamedin, si dhe për Familjen e tij dhe të gjithë Shokët e tij.

Ue Es-Selamu alejkum ue rrahmetullahi ue berekatuhu.

Burimi: <http://www.binbaz.org.sa/mat/8576>

Përktheu: Muhamed Kallashi